



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 30.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.05.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik GJEO-PROJEKT SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Platforma digjitale në GIS për infrastrukturë rrugore", Nr. i prokurimit- 632-23-14222-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-201-121, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik GJEO-PROJEKT SH.P.K, e dt.27.05.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Platforma digjitale në GIS për infrastrukturë rrugore", Nr. i prokurimit- 632-23-14222-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-201-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 20.05.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 20.05.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik GJEO-PROJEKT SH.P.K., me dt.27.05.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Platforma digjitale në GIS për infrastrukturë rrugore", Nr. i prokurimit- 632-23-14222-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-201-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 30.05.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë, sepse pasi që kemi kërkuar sqarime shtesë në lidhje me certifikatën e dorëzuar nga ju për menaxherin z. Suad Çmega, Autoriteti kontraktues ka konstatuar se certifikata e lëshuar është certifikatë për aftësimin e përdorimit të softuerit Global Mapper (softuer për GIS), ku në sqarimet e dërguara nga Blue Marbel si prodhuese e këtij softueri konfirmohet se ju si operatorë jeni të autorizuar për shitje të këtij softueri për mirëmbajtjen e tij si dhe të certifikoni stafin e kompanisë në lidhje me trajnimin e personelit për mbështetje para dhe pas shitjes. Ku në fund thotë se nëse dëshironi të blini produktet tona ju rekomandojmë që të bashkëpunoni me GJEO-PROJEKT SHPK.

Kërkesa për këtë projekt ka qenë që menaxheri/ja të jetë e certifikuar me certifikatë për GIS, certifikatë kjo e lëshuar nga një organizatë apo institut që tregon se menaxheri/ja ka kryer me sukses trajnime profesionale për GIS në module të caktuara. Pra, nuk është kërkuar certifikatë që tregon se menaxheri/ja është e certifikuar për përdorim të softuerit për GIS, andaj certifikata e lëshuar nga ju për personelin tuaj nuk e plotëson kërkesën e këtij tenderi prandaj ju është kërkuar sqarime shtesë ku kompania Blue Marbel e konfirmon rolin dhe certifikatën që ju lëshoni, por që e njëjta nuk është ajo që kemi kërkuar ne.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

